



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 399 Prot.

Tiranë, më 15. 11 .2019

U R D H Ë R
Nr. 85 datë 15 / 11 /2019

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE BRENDSHME
PËR NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË INSTITUCIONIN E
AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR-ASIG”**

Në zbatim të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, Vendimit nr. 147, datë 20.02.2013, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, Rregullore së brendshme për funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, miratuar me Urdhrin nr. 8, datë 31.08.2017 dhe Kodit të Etikës, miratuar me Urdhrin nr. 28, datë 16.06.2015,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme për ndalimin e pirjes së duhanit në institucionin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen punonjësit e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor- ASIG, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Lorenc Çala





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR

Nr. 399/1 Prot.

Tiranë, më 15.11.2019

RREGULLORE E BRENDSHME

“PËR NDALIMIN E PIRJES SË DUHANIT NË INSTITUCIONIN E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR – ASIG”

Neni 1

Baza Ligjore

Ligji nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, Rregullore e brendshme për funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, miratuar me Urdhrin nr. 8, datë 31.08.2017 dhe Kodi I Etikës, miratuar me Urdhrin nr. 28, datë 16.06.2015.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim marrjen dhe zbatimin e masave parandaluese për ndalimin e pirjes së duhanit brenda ambjenteve të punës së institucionit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (në vijim ASIG), për të garantuar shëndetin e personelit të ASIG dhe të personave të tjerë në mjediset e institucionit, duke patur parasysh pasojat e dëmshme që sjell duhani për shëndetin e njeriut.

Neni 3

Përkufizime

1. “**Mjedis pune**” konsiderohet çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat për të cilat janë punësuar, si dhe salla mbledhesh, korridore, shkallë, dhoma tualeti dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës, në ASIG.
2. “**Pirje duhani**” është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet, si dhe e cigares elektronike.
3. “**Produkte duhani**” nënkupton produktet që mund të konsumohen dhe të përmbajnë, qoftë edhe pjesërisht, duhan të modifikuar gjenetikisht ose jo.

4. **“Tavllë duhani”** është një enë e vogël ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.
5. **“Masat parandaluese të duhanpirjes”** janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të ASIG apo personave të tjerë që për arsye pune vijnë në institucion, duke zgjatur jetën dhe përmirësuar cilësinë e saj.

Neni 4

Masat për ndalimin e pirjes së duhanit

Pirja e duhanit nënkupton përdorimin e produkteve të duhanit brenda mjediseve të punës në institucionin e ASIG, duke marrë parasysh pasojat e rënda në shëndetin e njeriut dhe ekspozimin e pavullnetshëm ndaj tymit të çliruar, ndaj personave të tjerë.

Ndalohet konsumi i produkteve të duhanit në ambjentet e punës së ASIG, si më poshtë:

- Zyra;
- Korridore;
- Tualete;
- Mjedise të përbashkëta të godinës.

ASIG duhet të marrë masat për vendosjen e shenjave të dukshme paralajmëruese që tregojnë ndalimin e pirjes së duhanit në këto ambjente.

Në faqen zyrtare të internetit www.asig.gov.al, do të publikohet në vënd të dukshëm, një mesazh informues dhe sensibilizues për ndikimin e pirjes së duhanit dhe pasojave të tij në shëndetin e njeriut.

Neni 5

Autoriteti Përgjegjës

Institucioni përgjegjës për kontrollin e zbatimit të këtij ligji është Inspektoriati që mbulon fushën e punës, fushën e shëndetit dhe inspektoriati i sigurisë ndaj zjarrit.

Neni 6

Masat administrative

Për shkeljen e nenit 15, pika “a” të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, dënohen me gjobë si më poshtë:

50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucion.

5.000 (pesë mijë) lekë, duhanpirësi.

Masa e gjobës jepet nga trupa inspektuese, në përputhje me ligjin për inspektimin.

Gjithashtu, për shkeljen e sipërcituar, konsiderohet shkelje e lehtë e detyrës për nëpunësin civil dhe jepet masë disiplinore nga eprori direkt “Vërejtje”, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të Rregullores së Brendshme për funksionimin

e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, dhe Kodin e Etikës, së ASIG, ndërsa për punonjësit me kontratë pune u referohet akteve përkatëse të kontratës individuale të punës, lidhur me masat disiplinore.

Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në gjykatën administrative të rrethit, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e Ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 7 **Personi përgjegjës**

Personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kësaj rregulloreje të brendshme “Për ndalimin e pirjes së duhanit në institucionin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, është Specialisti i burimeve njerëzore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.

Neni 8 **Ankimi**

1. Për çdo çështje që nuk gjen trajtim në këtë rregullore zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar, Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, Ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
2. Çdo punonjës duhet të njihet me këtë rregullore dhe duhet t’i vihet në dispozicion një kopje e saj.
3. Të gjithë punonjësit e ASIG janë të detyruar të zbatojnë Rregulloren e Brendshme “Për ndalimin e pirjes së duhanit në institucionin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lorenc Çata

